



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 6 datë 31.1.2024

**PËR NJË NDRYSHIM TË PJESSHËM TË VKB NR. 51 DATË 14.04.2009
“MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE QË KËRKOHEN PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË
BASHKISË SHKODËR”, MIRATUAR ME VKM NR. 421 DATË 02.06.2010, TË
NDRYSHUAR, SIPAS LIDHJES 1, TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 126, SIPAS
FORMULARIT PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE.**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.1.2024, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i ndryshuar neni 9, pika 1.2 germa “a” dhe “c”; ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; të ligjit Nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; neni 11; VKM nr. 421, datë 02.06.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar; VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve“ Kreu II , pika 3 , Relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimin e fushës së përdorimit, emertimit për pasurinë si dhe përditësimin e sipërfaqes së pasurisë publike të transferuar në pronësi të Bashkisë Shkodër, me VKM nr. 421 datë 02.06.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar, si me poshtë :

Objekti “Shesh ish Kombinati Drunit , Zona Industriale”, me numër rendor inventarizimi 126, sipas lidhjes 1, pronë që përdoren në fushën *Zhvillim ekonomik industrial* , pasuri e

çertifikuar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ish ZVRPP) , me nr. Pasurie 17/17 , zonën kadastrale 8593 Shkodër me datë 29.05.2012.

Ishte

- Emertimi i Objektivit " Shesh ish Kombinati Drunit , Zona Industriale "

Fusha e përdorimit: Zhvillim ekonomik (industrial)

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones(m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese(m ²)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera(Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
126	8593 D-12	17/17	Truall	Shesh ish Kombinati Drunit Zona Industriale	2288	2288	Zhvillim ekonomik	Bashkia Shkoder	Bashkia Shkoder	

Behet

- Emertimi i Objektivit " Truall per ndertim të Banesave Sociale "

Fusha e përdorimit e propozuar :Sherbim Social

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones(m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese(m ²)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera(Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
126	8593 D-12	17/17	Truall	Truall per Ndertim te Banesave Sociale "Fruga Stom Golem"	2806	885	Truall per ndetim te Banesave Sociale	Bashkia Shkoder	Bashkia Shkoder	Objekti eshte pjeserisht Karabina Jashta funksionit

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015

"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Llesha

Miratuar me 40 vota

Vota Pro 40

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 6.2.2024